



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 1012/ 2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala, kryesues, Ymer Hoxha dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Mitrovicë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega Mitrovicë për shkak të parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

## **V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Mitrovicë

### **Arsyetim**

PZAP-i , më datën 02.12.2013, ka pranuar një ankesë nga PDK-ja me të cilën pretendohet se në Vendvotimin nr të QV 1102X/11R pasi është hapur kutia e votimit është gjetur një fletëvotim fals dhe se për votim është njoftuar Prokuroria e cila ka dalë në vend, andaj sipas parashtruesit të ankesës dyshohet se fletëvotime të tilla ka në shumë vendvotime dhe në qendrat e tjera të votimit. Sipas parashtruesit të ankesës parregullsi të tilla janë vërejtur edhe në piken e votimit 1114B/02D ku personat e njëjtë kanë ardhur disa herë si përcjellës të votuesve të moshuar duke deklaruar se këta nuk shohin dhe nuk dinë të lexojnë, derisa një plakë para të gjithëve i thotë se ajo dinë të lexojë dhe të shkruaj dhe se nuk ka nevojë për ndihmë. Parashtruesi i ankesës më tutje thekson se gjatë tërë kohës në oborrin dhe korridorin e shkollës kanë qëndruar personat e njëjtë të cilët ju afroreshin votuesve dhe ju sugjeronin për kënd që të votojnë dhe duke ofruar mjete materiale për votë.

Lidhur me rastin në fjalë PZAP-i kërkoi informacione shtesë nga Policia e Kosovës, ku me këtë rast nga policia e Kosovës ka pranuar raportin e hetuesit me nr 5243 të datës 03.12.2013, përkritazi me rastin e parashtruarë e ku sipas raportit saj rrjedh se

do të ndërrohen veprimet e tjera hetimore në identifikimin e të dyshuarit me qëllim të ndriçimit të secilit rast.

PZAP-i, e informoi subjektin politik AKR në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 03.12.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 04.12.2013, në ora 10:00. Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AKR në të cilën deklaroi se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar nga fakti se subjekti politik AKR deklaroi se procesi zgjedhor në Mitrovicë ka kaluar i rregullt dhe pa asnjë incident nga ana e AKR-së dhe se pretendimet e PDK-së në Mitrovicë se ka gjetur një fletëvotim fals në QV 1102X /11R ky fletëvotim nuk ka të bëjë asgjë me AKR, pasi që këtë ka mundur ta bëjnë aktivist të PDK-së apo qytetarë të thjeshtë me qëllim që ta dëmtojnë procesin zgjedhor dhe AKR-në dhe se fotografit të cilat janë sjellë si dëshmi janë shumë të pa qarta të paverifikueshme në bazë të cilave nuk mund të verifikohet asgjë e aq më pak të akuzohet për diçka të tillë pasi që në foto nuk shihet asnjë detaj se AKR ka të bëjë me diçka të tillë

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

#### **Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i për ta vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë, bëri administrimin e provave në shkresat e lëndës dhe njëherit doli në vend shikim në QNR fillimisht nxorri si provë dhe një kopje të saj e mori siç është FRP për nr e Venvotimit 1102X/011R i cili ishte nënshkruar nga shtatë anëtarë, u nxorr si provë libri i votimit 11 Mitrovica e Jugut i cili ishte i nënshkruar nga shtatë anëtarë dhe pesë vëzhgues, është bërë verifikimi i numrave të shiritave. Është bërë verifikimi i dy pakove të gjendura në kuti, njëra me fletëvotime të pa përdorura dhe tjetra pako me fletëvotime të vlefshme në numër prej 231 fletëvotime. Në këtë pako ishin dy grumbuj të fletëvotimeve njëra me shenjen PDK me nr të fletëvotimeve 128 ndërsa tjetri grumbuj me shenjen AKR 103 me fletëvotime.

Anëtarët e PZAP-it të gjitha fletëvotimet, duke marrë parasysh si ato fletëvotime me shenjen PDK dhe AKR në shumën prej 231 fletëvotimeve i verifikoi në bazë të llupës dhe llampës ultravjollcë dhe konstatoi se të gjitha fletëvotimet i kanë të gjitha shenjat e sigurisë, që vërtetohet se të gjitha këto fletëvotime janë origjinale. Sa i përket pretendimeve ankimore se në këtë kuti të votimit nr 1102x/11R gjindet fletëvotimet e falsifikuara ky pretendim ishte i pabazuar ngase anëtarët e PZAP-it vërtetuan se në kutinë e cituar më lartë asnjë fletëvotim nuk gjindet i falsifikuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore shitesë që i ka bërë ankuesi PZAP konstaton se pretendimet ankimore në fjale janë të pa bazuara ngase ankuesi këto pretendime ankimore nuk i ka argumentuar me asnjë provë relevante.

PZAP-i edhe pse morri vendim që ta verifikoj kutinë e votimit 1114B-02D këtë nuk e bëri në QNR përshkak se pretendimet ankimore nuk kishin të bënin me parregullsi

për fletëvotime por kishin të bënin me parregullsi sipas ankuesit jashtë Qendrës së votimit dhe për persona të cilët nuk ishin identifikuar nga ankuesi. Për këtë arsye edhe ky pretendim ankimor shtesë u deshtë që të refuzohet si i pa bazuar.

PZAP-i konstaton se me këtë rast nuk është arritur që të vërtetohen pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë. Andaj, në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prandaj, çështja e sipërshtuar nga pala ankuese mund të jetë objekt hetimi e shqyrtimi i institucioneve tjera te ndjekjes, policisë, prokurorisë etj.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr. 1012/2013 më datën 04.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Hasan Shafa**



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.